



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:098768

Datë: 25.02.2025

Numri i dokumentit: 06896880

P.nr.290/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale kundër të pandehurve R.K dhe I.B nga Peja, për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të pandehurit N.P, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Kanosja*” nga neni 181 par.2 të KPRK-së, si dhe veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP/II.nr.117/2024, të datës 25.03.2024, pas referimit të çështjes në procedurën e ndërmjetësimit, si dhe pas pranimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit të dt.21.02.2025, në kuptim të nenit 229 par.5 e lidhur me nenin 357 par. 1 nën par. 1.3 dhe par. 2 të KPRK-së, jashtë seancës, me datën 25.02.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET**– marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me nr. të referencës të ndërmjetësimit ND.nr.87/25 e dt.21.02.2025, në mes të pandehurve njëkohësisht të dëmtuar R.K, I.B dhe N.P ashtu që:
- II. HUDHET**, aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.117/2024, të datës 25.03.2024, ndaj të pandehurve R.K dhe I.B nga Peja, për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të pandehurit N.P nga Peja, për shkak të veprës penale “*Kanosja*” nga neni 181 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), për shkak të arritjes së marrëveshjes së ndërmjetësimit.

- III. PUSHOHET**, procedura penale, kundër të pandehurve R.K dhe I.B nga Peja, për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të pandehurit N.P nga Peja, për shkak të veprës penale “*Kanosja*” nga neni 181 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).
- IV.** Marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- V. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.**

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me datën 25.03.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.117/2024, kundër të pandehurit R.K nga Peja si dhe ndaj të pandehurit I.B nga Peja, për shkak të veprës penale “*Sulmi*” nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të pandehurit N.P nga Peja, për shkak të veprës penale “*Kanosja*” nga neni 181 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale “*Lëndim i lehtë trupor*” nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Gjykata me datën 21.02.2025, ka caktuar seancën fillestare në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Argzon Hasi, i pandehuri R.K, mbrojtësi i tij Esad Muharremi, avokat nga Peja, sipas autorizimit, si dhe të pandehurit I.B si dhe N.P.

Në këtë seancë mbrojtësi i të pandehurit R.K, avokati Esad Muharremi, i ka propozuar gjykatës që kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit pasi që të pandehurit që në këtë rast e kanë edhe cilësinë e palëve të dëmtuara, janë pajtuar dhe japin pëlqimin që kjo çështje të shkoj në procedurën e ndërmjetësimit. Këtë propozim të mbrojtësit të të pandehurit R.K, avokatit Esad Muharremi e kanë mbështetur edhe të pandehurit, që janë edhe në cilësinë e të dëmtuarve R.K, I.B si dhe N.P. Po ashtu lidhur me këtë propozim, edhe prokurori i shtetit ka deklaruar se: *pajtohem me propozimin e mbrojtësit të të pandehurit, jap miratimin që kjo çështje penale të shkojë në procedurë të ndërmjetësimit pasi që i plotëson kushtet.*

Gjykata me datën 21.02.2025, e ka referuar këtë lëndë në procedurë të ndërmjetësimit, në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësim i cili në nenin 8, par.1, parasheh se: *“Procedura e ndërmjetësimit mund të iniciohet nga palët, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ sipas legjislacionit në fuqi”*, ndërsa në par.2, po të këtij neni parasheh, *“nëse rasti gjendet në gjykatë, prokurori apo në organin kompetent administrativ dhe palët pajtohen për të shkuar në ndërmjetësim, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ informon dhe udhëzon palët në procedurën e ndërmjetësimit”*.

Po ashtu, sipas nenit 229 par.1, të KPPRK-së, parasheh se: *“Para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet apo me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim. Pas ngritjes së aktakuzës, me miratim të prokurorit, i dëmtuari dhe i pandehuri apo gjyqtari i vetëm gjykues mund ta referoj çështjen, për këto vepra në ndërmjetësim. Para se ta bëjë këtë, prokurori i shtetit apo gjyqtari i vetëm gjykues merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij dhe nëse ndërmjetësimi është në interes të të dëmtuarit ose viktimës”*.

Ndërkaq, gjykata me datën 21.02.2025, ka pranuar marrëveshjen nga Qendra e Ndërmjetësimit në Pejë, me numër të referencës të ndërmjetësimit ND.nr.87/25, përmes të cilit është njoftuar se në mes të pandehurve që janë edhe në cilësinë e të dëmtuarve, R.K, I.B si dhe N.P, është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit.

Sipas marrëveshjes së arritur ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit palët kanë deklaruar marrëveshjen se: Palët në seancën e ndërmjetësimit të mbajtur 21.02.2025 u pajtuan si me poshtë: Palët "B" (R.K dhe I.B) deklarojnë njëzëri se i kërkojnë falje palës "A" këtu N.P për rastin që ka ndodhur duke shtuar se rastet e tilla nuk do të përsëriten më. Pala "A" ka deklaruar se e pranon kërkim faljen nga ana e palëve "B", duke shtuar se çdo gjë është në rregull në mes neve. Pala "A" N.P deklaron se në një situatë të tillë si palë e dëmtuar, pasi që është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit, deklaron se nuk ka interes juridik që të vazhdohet ndjekja penale ndaj palëve "B" këtu R.K dhe I.B të cilët u deklaruan se pajtohen me deklarimin e palës "A" këtu i dëmtuari N.P. Tutje, pala "B" këtu N.P, po ashtu ka deklaruar se i kërkon falje palëve "A" këtu të dëmtuarve R.K dhe I.B për rastin që ka ndodhur, duke shtuar se raste të tilla nuk do të përsëriten

më. Palët “A” këtu të dëmtuarit, R.K dhe I.B deklaruan se e pranojnë kërkim faljen nga ana e palës “B”, duke shtuar se çdo gjë është në rregull në mes tyre. Palët “A” R.K dhe I.B deklaruan se në një situatë të tillë, si palë të dëmtuara, në këtë rast pasi që është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit deklarojnë se nuk kanë interes juridik që të vazhdohet ndjekja penale ndaj palës “B” dhe duke shtuar se nuk ka kërkesë për kompensim. Tutje, pala “B” këtu N.P deklaroi se i kërkon falje palës “A” këtu R.K për rastin që ka ndodhur, duke shtuar se raste të tillë nuk do të përsëriten më. Pala “A” këtu i dëmtuari R.K deklaroi se e pranon kërkim faljen nga ana e palës “B”, duke shtuar se çdo gjë është në rregull në mes neve dhe nuk kërkon kompensim. Me këtë rast palët e konsiderojnë rastin e mbyllur me këtë marrëveshje të arritur në procedurë të ndërmjetësimit.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e pasi që në rastin konkret Prokurori i Shtetit ka dhënë miratimin, dhe pasi që mes të pandehurve që janë edhe në cilësinë e të dëmtuarve është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit me datë 21.02.2025, gjykata ka analizuar marrëveshjen në fjalë dhe ka gjetur se palët kanë lidhur marrëveshjen e ndërmjetësimit me vullnet të lirë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-009 Për Ndërmjetësim, përkatësisht nenet 12 dhe 15 paragrafi 1, andaj të njëjtën e aprovoi si dhe ta hedhë aktakuzën e prokurorisë dhe rrjedhimisht ta pushojë procedurën penale ndaj të pandehurve R.K, I.B si dhe N.P, në kuptim të nenit 229 par. 5 të KPPRK-së¹, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit, përkatësisht hodhi aktakuzën dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurve, duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 5 dhe nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së.

Vendimi si në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktvendimi, se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve në këtë çështje penale, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi, u mor konform nenit 229 par.6 të KPPRK-së.

Vendimi si në pikën V, të dispozitivit të këtij aktvendimi, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale u mor konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

¹ Me marrjen e njoftimit për arritjen e marrëveshjes, prokurori i shtetit e hedh kallëzimin penal ose e ndërprente procedurën penale. Nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprente procedurën penale.

Prandaj, nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 229 par. 5 e lidhur me nenin 357 par. 1 nën par. 1.3 dhe par. 2 dhe nenit 453 të KPPRK-së, dhe nenin 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësimin, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - Divizioni Penal
P.nr.290/24, me datë 25.02.2025.

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Blerta KELMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej tri (3) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.